



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 860/2 Prot.

Tiranë, më 10 / 09 / 2018

V E N D I M

Nr. 173 , Datë 10 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. 86, datë 08.06.2018 të paraqitur nga shtetasi B.M kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Fushë Krujë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në takimin e zhvilluar me inspektorët e Komisionerit në datë 07.06.2018, subjekti ankues deklaroi se: *“Në datë 26.04.2018 është transferuar nga IEVP Fier në IEVP Fushë Krujë. Që prej vitit 2016 vuan nga zemra dhe me rekomandimin e mjekut duhet të mjekohet me medikamentin Amidaron dhe Spironolacton. Nga të gjithë medikamentet që duhet të mjekohet i mungojnë Spironolactoni dhe ilaçi i prostatës. Nga IEVP Fushë Krujë nuk i vihen në dispozicion këto ilaçe pasi mjeku i institucionit justifikohet me pretendimin se nuk ka. Kur ka qenë në IEVP Fier është trajtuar me këto medikamente. Gjithashtu ankuesi kërkon që për shkak të gjendjes shëndetësore të vendoset në një dhomë që të ketë ajrosje më të madhe dhe që të mos ketë mbeturinat afër”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe trajtimin sipas kushteve shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,*

gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr.860 prot., datë 14.06.2018 është njoftuar IEVP Fushë Krujë dhe i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ngritura nga shtetasi B.M.

Me shkresën me nr.1378, datë 18.06.2018 IEVP Fushë Krujë, informon Komisionerin se: “I dënuari B.M në datë 27.04.2018 është transferuar nga IEVP Fier bashkë me dosjen e tij personale. Në momentin e pranimit në institucion i dënuari është akomoduar në mjediset e observimit. Referuar rekomandimeve të mjekëve specialistë i dënuari trajtohet me terapinë si më poshtë: 1-Aspirin 100mg, atorvastatine 20mg, furosemide 40mg, spironalacton 25mg, amiodaron 20mg dhe xastral 10mg. Në momentin e transferimit nga IEVP Fier, i dënuari nuk është shoqëruar me terapinë përkatëse, në këto kushte nga ana e IEVP Fushë Krujë i janë siguruar medikamentet e mësipërme me përjashtim të medikamentit spironolacton të cilën nuk e disponojnë në farmaci dhe as në farmacinë e D.P.Burgjeve, si pasojë sigurimi i medikamentit është i mundur vetëm pas përfundimit të afatit të recetës së rimbursueshme të lëshuar nga mjeku i IEVP Fier që është në datë 20.06.2018, ndërsa në lidhje me medikamentin xastral, këtë medikament pacienti e ka marrë rregullisht. Në lidhje me pretendimin për ajrosje dhe akomodimin e ankuesit, informojmë se i dënuari është akomoduar dhe trajtohet sipas parashikimeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe duke patur parasysh problemet

¹ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

shëndetësore, të dënuarit i është siguruar ajrim i zgjatur që është i barabartë me harkun kohor të orarit të veprimeve nga ora 08.00 deri në orën 19.00 si në ditë normale pune ashtu dhe në ditët e pushimit zyrtar”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankuesit nga I EVP Fushë Krujë.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesi është transferuar pranë I EVP Fushë Krujë, në datë 27.04.2018 dhe vuan dënimin në burgun e sigurisë së zakonshme. Referuar aktit: Përmbledhje e daljes të shtetasit B.M të lëshuar nga Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve datë 26.02.2018, vërtetohet se ankuesi është diagnostifikuar me: “IKK, NYHA III-IV, Stenozë e valvulës së aortës e rëndë, Regurgital mitral i përparuar aortal i moderuar dhe ESA dhe është rekomanduar që i sëmuri: -Të jetë në ndjekje nga mjeku i I EVP, kardiologu, urologu në vazhdimësi.- Të jetë nën monitorim të vazhdueshëm të paramentrave vitalë. –Të marrë terapinë në rregull”. Në rekomandimet e mjekut kardiolog të datës 11.06.2018 i sëmuri duhej të trajtohej me terapinë si më poshtë: aspirin 100mg, atorvastatine 20mg, furosemide 40mg, spironalacton 25mg dhe cordarone 200mg.

Duke iu referuar komunikimit zyrtar me I EVP Fushë Krujë, si dhe deklaratave të ankuesit, rezultoi se shtetasit B.M i janë bërë vizita dhe konsulta mjekësore në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qenë nën trajtim mjekësor si nga I EVP Fier dhe nga I EVP Fushë Krujë. Kjo është verifikuar nga kartela mjekësore e ankuesit në të cilën është shënuar diagnoza dhe mjekimi që duhet të marrë, ndërkohë që nga deklaratimet e palëve pohohet që i dënuari B.M nga periudha e transferimit nga I EVP Fier deri më datë 18.06.2018, pra për rreth një periudhe prej shtatë javësh, nuk është trajtuar me medikamentin (spironolacton) e rekomanduar nga mjekët². Pra, konstatojmë se nuk ka marrë të plotë mjekimin e rekomanduar nga mjekët.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për akomodimin e tij në një mjedis më të ajrosur, Komisioneri vlerëson se ankuesit nuk i është rekomanduar nga mjeku specialist, kushte të veçanta akomodimi dhe se masat e marra nga ana e I EVP Fushë Krujë duke e vendosur në një dhomë më vete në mjediset e observimit dhe krijimi i lehtësisë për t’i siguruar një orar të zgjatur për ajrim përbën një veprim pozitiv të drejtuesve të I EVP Fushë Krujë në drejtim të sigurimit të kushteve më të mira për të dënuarin për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Në këto kushte, Komisioneri mori në shqyrtim vetëm mos sigurimin e medikamentit spironalacton të rekomanduar nga mjekët.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo*

² Përmbledhje e daljes datë 05.02.2018 nga Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve për pacientin B.M.

bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.* Neni 25, përcakton se: *“Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti”.*

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore³ (KEDNJ), është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe sipas nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit, përcakton se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.*

Gjithashtu, edhe neni 1 i Protokollit Nr.12 të KEDNJ-së parashikon që: *“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

Në këtë kontekst, në nenin 3 të Konventës parashikohet se: *“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”.* Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka renditur shpesh e në mënyrë të përsëritur nenin 3⁴, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor, së bashku me nenin 2, të drejtën për jetën, si një nga të drejtat më themelore që mbrohen nga Konventa, qëllimi thelbësor i së cilës është që të mbrojë dinjitetin e një individi e integritetin e tij fizik. Termat e pakushtëzuar të nenit 3 nënkuptojnë se asnjëherë, në bazë të Konventës ose të së drejtës ndërkombëtare, nuk do të ketë justifikim për aktet që çenojnë këtë nen. “GJEDNJ-ja shprehet se edhe në rrethanat më të vështira, si për shembull, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, Konventa ndalon në terma absolutë torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor apo poshtëruës. Duhet theksuar fakti se ndalimi absolut zbatohet njësoj në çështjen e trajtimit të personave të ndaluar me motive mjekësore dhe/ose që i nënshtrohen trajtimit mjekësor. Në këtë kontekst, i përket autoriteteve mjekësore që të vendosin, në bazë të rregullave

³ Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ e ratifikuar nga R.SH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

⁴ Neni 3 i KEDNJ-së “Ndalimi i torturës”, përcakton se: “Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese”.

të njohura të shkencës së mjekësisë për metodat terapeutike që duhen përdorur, për të ruajtur shëndetin fizik dhe mendor të pacientëve. Pacientë të tillë mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, të Konventës, kushtet e të cilit nuk lejojnë devijime. Autoritetet përgjegjëse të një shteti kanë detyrimin që të mbrojnë shëndetin e personave që u është hequr liria. Mungesa e trajtimit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim që bie ndesh me nenin 3, të KEDNJ-së⁵.

Komisioneri lidhur me çështjen e B.M, ka konstatuar se gjatë periudhës nga data 27.04.2018 deri më datë 18.06.2018, ankuesi ishte trajtuar pjesërisht me medikamente dhe jo me kurën e plotë të cilën kishte shënuar mjeku në kartelen e B.M. Ky shërbim nuk i është mundësuar ankuesit për një periudhë prej shtatë javësh. Përgjegjësia për sigurimin e medikamenteve është e përfaqësuesve të I EVP Fushë Krujë dhe jo e individit, i cili është në kushtet e dënimit me burgim dhe i pamundur për t'i siguruar vetë medikamentet që i nevojiten për shëndetin e tij.

Sigurimi i shërbimit mjekësor i të dënuarve që vuajnë dënimin në I EVP rregullohet sipas ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Në nenin 33, Shërbimi mjekësor, shkruhet: *“Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, sipas skemës në fuqi pavarësisht nga kërkesat e të paraburgosurve dhe të dënuarve”*.

Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, Kreu XIX, Shërbimi Shëndetësor, Neni 102/1, “Organizimi i kujdesit shëndetësor në I EVP”, përcaktohet se: *“Shërbimi shëndetësor sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion dhe mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor sipas legjislacionit në fuqi. I EVP-të sigurojnë shërbim shëndetësor pa ndërprerje, nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor”*. Ndërsa në nenin 107/2 “Medikamentet mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre” të kësaj rregulloreje përcaktohet se: *“Trajtimi me medikamentet mjekësore bëhet nga farmacia e I EVP-së, ndërsa shpërndarja bëhet nga personeli shëndetësor”*.

Mungesa e kujdesit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Në këtë kontekst, po t'i referohemi raporteve mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të shtetasit B.M (depozituar në dosjen personale të tij, pranë KMD-së), të cilat i referoheshin trajtimit të tij mjekësor gjatë periudhës së qëndrimit në I EVP Fushë Krujë, ato pasqyrojnë faktin se ankuesi ishte trajtuar pjesërisht me ilaçe dhe jo me kurën e plotë të cilën kishte shënuar mjeku në kartelën e B.M. Neglizhenca e autoriteteve, përsa i përket mos sigurimit të ilaçeve të rekomanduara nga mjekët specialistë, përbën shkelje të të drejtave të tij, gjë që ka bërë që i dënuari të trajtohet në mënyrë të padrejtë në raport me përfitimet që parashikon legjislacioni (vendas dhe ndërkombëtar) dhe aktet e tjera.

⁵ Referuar Manualit të të Drejtave të Njeriut, Nr. 6 “Udhëzuesi mbi ndalimin e torturës”. Hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës F-67075 Strasbourg Cedex Këshilli i Evropës, 2001

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkakët e parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e mjekut të IEVP Fushë Krujë për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Gjatë trajtimit të ankesë së B.M, u administruan prova se ka patur një situatë paligjshmërie dhe neglizhence nga ana e personelit të IEVP Fushë Krujë, lidhur me trajtimin që duhej t’i afrohej në raport me ligjin, por nuk u siguruan prova apo informacion për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mos sigurimi i një medikamenti mjekësor për një periudhë prej shtatë javësh nga ana e IEVP Fushë Krujë është bërë për shkak të gjendjes shëndetësore të ankuesit.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar vërtetohet se IEVP Fushë Krujë që në momentin e mbërritjes së të dënuarit B.M, ishte në dijeni të mungesës së njërit prej medikamenteve të përshkruar në terapinë e tij dhe është justifikuar me faktin se i dënuari nuk është shoqëruar me terapinë përkatëse nga IEVP Fier dhe se medikamenti i kërkuar nuk disponohej në farmacinë e IEVP Fushë Krujë dhe as në farmacinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në rrethana të tilla, IEVP Fushë Krujë si institucioni përgjegjës për sigurimin e trajtimit mjekësor të ankuesit, duhet të kishte marrë masat e duhura për sigurimin e medikamentit ose të vinte në dispozicion të Komisionerit prova për të vërtetuar se nga ana e saj ishin ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar terapinë e plotë të të dënuarit, duke vënë në dispozicion të Komisionerit korrespondencën me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për rastin në fjalë si dhe komunikimin me IEVP Fier në lidhje sigurimin e medikamentit deri në përfundim të afatit të recetës së rimbursueshme.

Si rezultat, Komisioneri është i mendimit se IEVP Fushë Krujë nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për mungesën e medikamentit dhe arsyet përse autoritetet nuk mund t'i siguronin ankuesit medikamentin në kohën e duhur. Gjatë periudhës së sipërcituar, IEVP Fushë Krujë ka dështuar në trajtimin mjekësor të të dënuarit. Shteti duhet të sigurojë ruajtjen e shëndetit dhe mirëqënies të të burgosurve edhe nëpërmjet ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore. Nëse autoritetet vendosin të mbajnë një person të sëmurë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për garantimin e kushteve të burgimit që përkojnë me nevojat e veçanta të të burgosurit që vijnë si rezultat i paaftësisë së tij (shih Paladi k. Moldavisë, nr. 39806/05, § 81, 10 korrik 2007).

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shtetasi B.M mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme e të parregullta të personelit të IEVP Fushë Krujë, por nuk përbën trajtim diskriminues në raport me të dënuarit e tjerë për shkak të gjendjes shëndetësore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1/3, nenin 7/1, nenin 32/1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 10, 11 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit B.M nga ana e IEVP Fushë Krujë, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Rekomandohet që IEVP Fushë Krujë, të marrë masa, që në të ardhmen, të dënuarve t'i sigurohen në kohë medikamentet mjekësore sipas rekomandimeve të mjekut.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: gjendja shendetesore)
(fusha: te mira dhe sherbime)